

## Si mëson fëmija im Gjermanisht? Si i përvetëson fëmija im dy gjuhë?

Të dashur prindër,

pyetje të tilla preokupojnë shumë prindër. Ne deshirojmë t'ju japim këshilla dhe ndihma në lidhje me ndihmën e fëmijës tuaj për një zhvillim të mirë gjuhësor.

- **Fëmijët mund të mesojnë lehtë gjuhë të ndryshme.**

Nqs. fëmija juaj edukohet me dy gjuhë, atëherë fëmija juaj ka një avantazh të madh për të ardhmen e tij. Nga studime të shumta ka rezultuar, se fëmijët mund të mesojnë disa gjuhë të ndryshme, kur u krijohen kushte të përshatshme për mesimin e gjuhëve përkatëse. Në këtë proces gjuha amtare ka një rol shumë të rëndësishëm.

- **Njohuri të mira në gjuhën amtare përbëjnë bazën për mesimin e një gjuhe të dyte ose të mëtejshme.**

Mundohuni fillimisht, që për një kohë të caktuar të flisni në një gjuhë me fëmijën tuaj. Në këtë mënyrë fëmijët mesojnë, se si është ndërtuar një gjuhë. Kjo praktikë i ofron fëmijës suaj orientim. Të folurit dhe të luajturit në gjuhën amtare nuk e pengon fëmijën tuaj në kuptimin dhe mesimin e gjermanishtes. Zakonisht nevojiten disa vite, deri sa një fëmijë të zotërojë një gjuhë.

Në faza të caktuara të zhvillimit disa fëmijë dëshirojnë të flasin vetëm një gjuhë të caktuar, si p. sh. Gjermanisht. Si pasojë ata përgjigjen gjermanisht edhe nëse prindërit e tyre flasin në gjuhën amtare me ta. Kjo është diçka krejt normale. Ju duhet me gjithatë të vazhdoni të komunikoni në gjuhën tuaj. Fëmija mëson më tej duke dëgjuar dhe me siguri ai/ajo do të flasë (përsëri) gjuhën tuaj më vonë.

Jeta e përditshme në familje ka shumë rëndësi për zhvillimin gjuhësor, sepse brenda familjes fëmijët mesojnë gjuhën e tyre të parë.

- **Dëgjoni fëmijën tuaj me vëmendje, përgjigjuni pyetjeve dhe inkurajoni fëmijën tuaj për të folur më tej.**

Një gjuhë nuk mund të mësohet dhunëshmërisht, ajo zhvillohet hap pas hapi, para se gjithash tek fëmijët e moshave të vogla, duke **dëgjuar dhe folur vetë** çdo ditë. Për shembull gjatë lojës, ngrënjes, gjatë bashkëbisedimit ose gjatë shikimit të ndonjë libri me ilustrime.

- **Është me rëndësi të veçantë, që prindërit, pavarësisht nga gjuha që perdorin, t'u dëgjojnë fëmijëve të tyre me vëmendje dhe të flasin me ta sa më shumë e në çdo situatë. Duke biseduar fëmija mëson të shprehet dhe të shpjegojë idetë dhe dëshirat e tij me fjalë.**

Ju duhet t'u përgjigjeni mundësisht të gjitha pyetjeve të fëmijës suaj. Ka raste që prindërit mendojnë, se e njohin fëmijën e tyre aq mirë, sa janë në gjendje të lexojnë nga sytë dëshirat e tyre, ne atë mënyrë, që fëmijet nuk nevojiten të formulojnë dëshirat e tyre. Por për përvetësimin e një gjuhe ka shumë rëndësi, që ju të nxitni fëmijën tuaj të flasë, ta inkurajoni dhe ndihmoni atë në formulimin e dëshirave dhe mendimeve të tij.

Ka aktivitete, nëpërmjet të cilave fëmijët zhvillojnë aftësitë gjuhësore të tyre tepër mirë. Ketu nënkuptohen para së gjithash të lexuarit, të treguarit, të shikuarit e librave me ilustrime, të kënduarit dhe recitimi i vjershave.

- **Keni parasysh, që në shtëpinë tuaj të ketë libra për të lexuar dhe me ilustrime, dhe kompakt-disqe me tregime. Programet televizive nuk mjaftojnë për zhvillimin e gjuhës.**

Televisioni i edukon fëmijët njëanshmërisht në shikimin dhe dëgjimin pasiv. Por të mësosh një gjuhë do të thotë të veprësh në mënyrë aktive. Mos i lini televizorit detyrën e mësuesit gjuhësor të fëmijës suaj. Në vënd të kësaj do të ishte mirë që prindërit të shikojnë bashkë me fëmijët e tyre të vegjël një libër me ilustrime, dhe mundësisht çdo ditë nga pak. Nqs ju në shtëpinë tuaj nuk keni libra të tillë në gjuhën tuaj, dhe nuk mund ti huazoni ato, atëherë ju keni një mundësi tjetër: Ka shumë libra me ilustrime të botuara në Gjermani për fëmijë, të cilat pothuajse nuk kanë ose kanë pak tekst. Atëhere ju mund të flisni në gjuhën tuaj me fëmijën tuaj mbi ilustrimet ose mund të zhvilloni sëbashku një përallë. Nqs ju flisni gjermanisht mirë, ju mund të flisni herë Gjermanisht, herë Shqip. Shpesh fëmijët kanë një libër të preferuar, të cilin ata duan ta shikojnë dhe të flasin për të herë pas here. Në këtë mënyrë ata sensibilizohen për gjuhën.

Fëmijëve u pëlqejnë tregimet. Nqs persona të rritur të familjes, te cilët fëmijët i duan, tregojnë tregime, gjuha e tyre zhvillohet automatikisht. Ata mësojnë të kuptojnë dhe të tregojnë vetë përalla. Kjo aftësi ka rëndësi të veçantë për shkollën. Po ashtu favorizojnë këngë, lojra me gishta dhe duar si dhe vjersha zhvillimin e aftësive gjuhësore. Përveç kësaj fëmijëve lojra të tilla u pëlqejnë shumë.

- **Krijoni mundësitë, ku femija juaj të praktikojë gjuhën Gjermane.**

Nqs një fëmijë ka besim në ambientin e tij/saj, pra nqs ai/ajo ndjehet mirë dhe merr pjesë, atëherë fëmija mëson gjuhën Gjermane në mënyrë të natyrshme dhe me lehtësi. Në çdo mjedis, jo vetëm në shtëpi dhe në shkollë fëmija juaj mëson Gjermanisht. Shfrytëzoni mundësitë e ambienteve shoqërore, si p.sh klubet sportive, këndet e lojrave, bibliotekat publike, pishinat etj.

- **Ofroni fëmijës suaj një shëmbull pozitiv me anë të sjelljes suaj.**

Fëmijët imitojnë sjelljen e prindërve. Këtu bën pjesë praktikimi i dygjuhësisë. Kjo do të thotë: përvetësimi i gjuhës Gjermane nga prindërit, lidhja e kontakteve me vëndasit Gjermanë, pra të veproni në të njejtën mënyrë, që ju prisni nga fëmija juaj.

Në këto përpjekje ju urojmë juve dhe fëmijës suaj shumë suksese.

Këtë informacion është hartuar në base të

“Wie lernt mein Kind zwei Sprachen, Deutsch und Familiensprache” Dr. Michael Ulrich,

Staatsinstitut für Frühpädagogik (Instituti shtetëror për pedagogjin e hershëm) (IFP), München

## Zhvillimin gjuhësor të fëmijës suaj mund ta mbështetni duke

U dëgjuar fëmijeve me vëmendje, u përgjigjur pyetjeve të tyre duke i inkurajuar ata për të folur

Njohuri të mira në gjuhën amtare janë të rëndësishme për fëmijën tuaj

Shembulli më i mirë për fëmijën tuaj jeni ju.

Krijimi i mundësive në të cilat fëmijët përdorin gjuhën Gjermane (klube sportive, biblioteka publike, kënde lojrash etj.)

Programet televizive nuk janë të mjaftueshme!  
Në shtëpi të keni libra, kompakt-disqe, kasete etj.